



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1239/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gafurr Shabani kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radha e AKR-së në Podujevë, paraqitur kundër përfaqësuesve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Podujevë, për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Gafurr Shabani, kandidate për anëtar të kuvendit komunal në Podujevë, nga radhët e Aleancë Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

Me datën 03.12.2013 në ora 16:10, Gafurr Shabani kandidate për anëtar të kuvendit komunal nga radha e AKR-së në Podujevë ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se fshatin Herticë, Orllan, Lluzhan, Majac t'i rinumërohen votat e tij pasi pretendon se ju kanë vjedhur votat nga komisionerët, thuhet në pretendimet e ankuesit.

Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Gafurr Shabani nga radha e AKR-së, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi apo provë, për të vërtetuar shkeljen e supozuar, andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1239/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.